

### BETO-RET



Njësia matëse	Copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
1 kg/bidon	12 cp/kuti	300-500gr / 100kg Cimento	Kafe
5 kg/bidon	4 cp/kuti	--	--
10 kg/bidon	60 cp/paletë	--	--
1000 KG/IBC	IBC	--	--



#### BETO - RET

Vonues në tharjen e betonit - Reduktues i sasisë së ujit dhe plastifikues

#### PËRSHKRIMI

BETO - RET është një aditiv i lëngshëm që vonon tharjen e betonit, pra zgjat kohën në të cilën betoni ka plasticitet. Në të njëjtën kohë redukton sasinë e ujit të nevojshëm për punuëshmerinë ose nga mbajtja e qëndrueshme e sasisë së ujit në përzierje, përmirëson punueshmërinë.

- Përveç kohës së tharjes, ai mundeson hidratim shumë të mirë të çimentos, duke rezultuar një rritje të konsiderueshme të rezistencave fillestare dhe përfundimtare të betonit.
  - Ngadalëson mpiksjen e betonit dhe parandalon ndarjen e agregatëve
  - Parandalon dukshëm plasaritjet që vijnë si pasojë e tkurrjeve të betonit.
  - Zvogëlon absorbueshmërinë e ujit në beton për shkak të reduktimit të porozitetit.
- BETO - RET është një shtesë e domosdoshme në përgatitjen me cilësi të lartë të betonit.
- Përmirëson rrjedhshmërinë e betonit dhe ngadalëson tharjen.
  - Lehtëson transportimin e betonit të gatshëm në distanca të gjata, veçanërisht në temperatura të larta.
  - Zhvillimi i forcimit nuk shkakton vonesa në heqjen e formave të drurit.
  - Në përputhje me standardin ELOT EN 934 - 2:2001, Tabela 10.
  - Ulja e sasisë së ujit në përzierje për përgatitjen e betonit me karakteristika të caktuara e arritur me shtimin e BETO - RET, lejon uljen e sasisë së çimentos me të njëjtën përqindje. Duke mbajtur raportin ujë / çimento konstante, betoni i prodhuar ruan cilësinë e dëshiruar.

#### DOZIMI

Dozimi i lejuar: 0.2 – 0.5% ne raport peshë çimento

#### TE DHËNAT TEKNIKE

Ngjyra	Kafe
Densiteti	1,11-1,17 kg/l
pH	≤ 7,9
Përmbajtja e klorit të lirë	Nuk përmban
Përmbajtja e bazave	≤ 4,5% në peshë

#### EFEKTIVITETI

Për çdo sasi të lejueshme dozimi arrihet një reduktim i ujit deri në masën 5 – 18%. Respektivisht ndodh një rritje e forcës finale nga 6 - 11%. Koha e fillimit të mpiksjes shkon nga 150 minuta deri në 200 minuta ndërkohë që e tharjes finale shkon nga 180 minuta deri në 240 minuta.

#### JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

12 muaj në paketim origjinal dhe të pahapur në temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Materiali duhet të jetë i mbrojtur nga rrezatimi i drejt-përdrejtë i diellit dhe ngricës.

#### VËREJTJE

- BETO - RET është i përshtatshëm për të gjitha llojet e çimentos Portland.
- Mbidozimi mund të shkaktojë tharje të përshpejtuar por nuk ndikon në rezistencat finale të betonit.
- Nëqoftese materiali ngrin, kthejeni në temperaturë +5°C dhe përzijeni deri sa të homogjenizohet përsëri.